



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARIMIT PRIVAT  
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ELVIN HOXHA  
ÇERTIFIKATE NR.206/JANAR 2015 NIPT.L42109004H  
Adresa: Rruga "Vaso Pasha" Nr.13/1, Ap.1, Tirane  
E-mail: [elvinth@hotmail.com](mailto:elvinth@hotmail.com) Mob: +355682029920

Nr.153/17  
Nr. 125 Prot.

Tiranë më datë 20/4 /2017

**URDHËR**

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

**Drejtuar :** QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

**Per Dijeni :** Shoqërisë "Sviluppo Mare 1" sh.p.k , Nr.Nipt L61706003C  
Kreditori Shoqëria "Tirana-Auto" sh.p.k

Prane zyres se Permbaruesit Gjyqësor Privat Elvin Hoxha është depozituar kërkesa e pales Shoqërisë "TIRANA-AUTO" sh.p.k së bashku me Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.2856 datë 11.04.2017 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lëshuar për Titullin Ekzekutiv *Aktin Noterial, Deklaratë Noteriale Nr.1737 Rep., Nr.370 Kol., datë 20.07.2015*, me palë:

**-Kreditor :** Shoqëria "TIRANA-AUTO" sh.p.k

**- Debitor :** Redi Daut Peza

**-Objekti:** Lëshimi i Urdhërit të Ekzekutimit për Deklaratën Noteriale Nr.1737 Rep., Nr.370 Kol., datë 20.07.2015.

Me Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr.2856 datë 11.04.2017 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur :

1. Pranimin e kërkesës.
2. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv , Deklaratën Noteriale me Nr.1737 Rep Nr.370 Kol., datë 20.07.2015 , hartuar përpara noterit publik Elmira Kodra në shumën e detyrimit prej 38,000 (tridhjetë e tete mije) Euro , ndaj debitorit Redi Peza , me vendbanim në Tiranë , me adresë , Njësia Bashkiake Nr.9 , Tiranë , Rr.Dull Keta" , Nr.14.
3. Ky vendim lëshohet në një kopje të vetme.
4. Urdhërohet Shërbimit Përmbarimor për ekzekutimin e këtij vendimi



Në kushtet kur Kërkuesi (Kreditori) Shoqëria "Tirana-Auto" sh.p.k identifikuar me Nr.NIPT K82318007Q referuar nenit 519 të K.Pr.Civile kërkon që të kalohet menjëherë në Ekzekutim të Detyrueshëm pasi pala debitore ka shmangur gjatë gjithë kësaj kohe pagimin e detyrimit , për vazhdimin e ekzekutimit të Urdhër Ekzekutimi Nr.2856 datë 11.04.2017 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë , nga ana e Permbaruesit Gjyqësor Privat duhet te kryhet vendosja e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore Redi Daut Peza , ne masen qe zoteron prane kesaj shoqerie.

**Si ne zbatim te neneve 527 e ne vijim te K.Pr.Civile dhe ligjit Nr.10031 , date 11.12.2008 "Per Sherbimin Permbarimor Gjyqësor Privat "**

**URDHEROJ :**

1-Vendosjen e mases se sekuestros konservative ne kuotat/aksionet e pales debitore **Redi Daut Peza i cili është administrator dhe ortak i vetëm pranë kësaj shoqërie** , si dhe mbi te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i ketyre kuotave duke ndaluar tjetersimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnje veprimi tjetër i cili mund te ndryshoje te dhenat ne regjistrin tregtar. Dokumentacioni do te qendroje i bllokuar deri ne nje urdher te dyte nga Permbaruesi Gjyqësor Elvin Hoxha .

**-Shoqeria "SVILUPPO MARE 1" sh.p.k me nr.NIPT L61706003C me adresë kryesore Rruga Ismail Qemali , Pallati Gener 2 , Kati 1 , Zyra I Tiranë.**

2- Per veprimet apo mos veprimet tuaja duhet te na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor

3- Personat qe behen pengese , do te pergjigjen ne baze te nenit 606 K.Pr.Civile (paragrafi II) qe parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallezimit penal.

4- Ky urdher mbahet ne disa kopje dhe u njoftohet paleve te cilat kan te drejten e ankimit ne Gjykate brenda 5 (pese) diteve.

---

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT  
ELVIN HOXHA**

